



Pranuar / Dorëzuar Puniljenë/Prodato Received/Delivuty	02. 03 2022	2 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSACK	1119/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.23/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.23/2022 të datës 13.01.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Vendimit me numër protokollit 1438/1 të datës 10.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Klllokotit, në çështjen juridike-administrative "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.23/2021 të datës 13.01.2022, të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja me datë 13.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 1438/1 të datës 10.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Klllokotit, me të cilin ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Komunën e Klllokotit në pozitën "Menaxhere e Bibliotekës Komunale", me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkelje të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.01.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Klllokotit. Ndërsa Këshilli me datë 26.01.2022, ka pranuar nga Komuna e Klllokotit përgjigjen në kërkesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 121/2022 të datës 13.01.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës



për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 1438/1 të datës 10.12.2004 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses; Ankesën e ankueses të datës 20.12.2021 drejtuar Komunës së Klllokotit; Shkresën sqaruuese të datës 20.12.2021 të parashtruar nga ankuesja; Akt emërimit e ankueses të datës 01.09.2011 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Vërtetimin me numër 1458/1 të datës 22.12.2021; Vendimin me numër 10544/1 të datës 28.05.2018 për pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.01.2022 e parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.01.2022 nga Komuna e Klllokotit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailin zyrtar të datës 28.01.2022 mbi pjesën e dytë të provave nga ana e Komunës së Klllokotit; Vendimin me numër Nr.236/1 të datës 11.02.2019; Vendimin me numër 1433/1 të datës 09.12.2004; E-mailin zyrtar të datës 27.01.2022; Raportin mjekësor të datës 10.12.2021 për ankuesen; Listën e pagës për ankuesen për muajt tetor-nëntor, Përgjigjen e datës 25.02.2022 lidhur me provat shtesë për ankuesen, Aktgjykimin me numër AA.nr.584/2021 të datës 09.11.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Aktgjykimin me numër A.nr.176/2018 të datës 22.01.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Aktvendimin e datës 19.07.2021 për ri caktimin e [redacted] në pozitën e Menaxherit të Bibliotekës Komunale, Ankesën e datës 29.12.2017 të [redacted] Akt emërimit me nr.prot:7568/1 të datës 19.07.2016 për [redacted] Akt emërimit me nr.prot:7149/1 të datës 13.04.2016 për [redacted] Vendimin me numër A.nr.208/2018 të datës 11.06.2018 të KPMSHCK-së sipas ankesës së [redacted] Vendimin me nr.prot.10602/1 të datës 28.06.2018 të Kryetarit të Komunës së Klllokotit për zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së, Vendimin me nr.prot:1486/1 të datës 23.12.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.23/2022 të datës 13.01.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, respektivisht sipas Akt emërimit të datës 01.09.2011, rezulton se ankuesja është e punësuar në Komunën e Klllokotit në pozitën e punës "Menaxhere e Bibliotekës Komunale". Me Vendimin me numër protokoll 1438/1 të datës 10.12.2021, Kryetari i Komunës së Klllokotit i ka ndërprerë ankueses marrëdhënien e punës si Menaxhere e Bibliotekës Komunale. E pakënaqur me këtë vendim, ankuesja me datë 13.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljeve të së drejtës materiale.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafin 4 ku është përcaktuar se: *Nëpunës i Shërbimit Publik është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike* si dhe mbështetur në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-097 për Bibliotekat ku është përcaktuar se Bibliotekat janë institucione kulturore, arsimore dhe informuese, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se pozita Menaxhere e bibliotekës komunale nuk hynë në kategorinë e pozitave të shërbimit civil përkatësisht pozita në fjalë e ankueses hynë në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik .

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të





shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesja ka statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.23/2021 të datës 13.01.2022, të parashtruar nga ankuesja

Bazuar në nenin 64 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, marrëdhënia e punës e nëpunësve të shërbimit publikë i nënshtrohet legjislacionit të punës, kështu që mbi këtë bazë e në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji rikujton ankuesen se Nëpunësi i Shërbimit Publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.23/2022

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Procesmbajtëse

**Ardita HAXHNIKAJ-DEMI**



*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit

#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kllokotit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kllokotit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

